



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E TREGTISE DHE INDUSTRIE-MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministry of Trade and Industry

Numri i Dokumentit: NJAB  
Data: 22.11.11

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarshtvo Trgovine i Industrije-*  
*Ministry of Trade and Industry*

**Njësia e Auditimit të Brendshëm**

<b>DATE/A:</b>	<b>22.11.2011</b>
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZATO:</b>	Znj. Eljana Naka , sekretare e përgjithshme në MTI -së
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Ibush Luzha, u.d. i drejtorit në Zyrën për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës në MTI -së Haki Maxhuni, drejtor i NJAB -së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Raporti Final i Auditimit të Brendshëm – Menaxhimi i Licencave në Zyrën për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës</b>

Të nderuar

Në shtojcë keni të bashkangjitur Raportin Final të Auditimit – Menaxhimi i Licencave në Zyrën për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës, të kryer bashkë me objektivat kryesore të dhënies së mendimit lidhur me përshkrimin e sistemit të kontrollit tuaj.

Raporti është i bazuar në operacionet e kryera gjatë periudhës 2010 dhe 2011. Në pajtim me praktikën tona të zakonshme, ne kemi kryer takimin përmbyllës me menaxherët e interesuar, në mënyrë që të pajtohemi me përmbajtjen faktike të raportit si dhe dokumentin final para se të publikohet.

Të gjitha kontradiktat lidhur me rekomandimet e dhëna janë në përputhje me praktikën tonë të zakonshme dhe janë tejkaluar kënaqshëm.

“Ju falënderojë për vëmendjen”

Me respekt,

Haki Maxhuni



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-  
Ministry of Trade and Industry

Njësia e Auditimit të Brendshëm

- RAPORTI FINAL I AUDITIMIT TË BRENDSHËM-

Procedurat e dhënies së Licencave subjekteve afariste.

Periudha 2010 dhe 2011

Nëntor 2011

Bazuar në Kërkesë të sekretares së përgjithshme

ORGANIZATA E AUDITUAR :

Ministria e Tregtisë dhe  
Industrisë

RAJONI(ET) E MBULUARA :  
SISTEMI OPERACIONAL:

Prishtinë  
Procedurat e dhënies së  
Licencave Subjektive  
Afaristë.

LLOJI I AUDITIMIT :

I performances,  
ligjshërisë dhe i  
regulimit

Drejtuesi i Ekipit të Auditimit:

Haki Maxhuni, drejtor i  
Njësisë së Auditimit të  
Brendshëm - MTI-së

Anëtar:

Idriz Kika, auditor i  
brendshëm

## PËRMBAJTJA

### PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

#### 1. PARATHËNIA

#### 2. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

Objektivat e auditimit

Fushëveprimi i Auditimit

#### 3. REZULTATET

3.1. KONSTATIMET

3.2. KONKLuzionET

3.3. REKOMANDIMET

## Përmbledhja ekzekutive

Kemi rishikuar aspektet e Menaxhimit - Procedurat e lëshuarjes së Licencave subjekteve afariste mbi përmbushjen e kushteve teknike për deponitë e importuesve të përgjithshëm dhe subjekteve të cilët merren me tregtimin e karburanteve me shumicë dhe pakicë.

Jemi pajtuar me menaxhmentin e lartë për objektivat dhe fushëveprimin e auditimit për vitin 2010 dhe 2011.

- Në shumicën e rasteve të kërkesave të parashtruara, dokumentacioni është pranuar si kopje e pa verifikuar qoftë nga gjykata ose nga organet përkatëse.
  - Për shqyrtimin e Kërkesave të parashtruara për licencim të subjekteve afariste të cilat merren tregtimin me naftë dhe derivate të saj Drejtori i Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës nuk ka lëshuar Vendim për formimin e Komisionit.
  - Para lëshimit të Vendimit nga ana e Drejtorit, kërkesat janë shqyrtuar prej tre (3) zyrtareve, por këta zyrtar asnjëherë nuk kanë mbajtur Procesverbal apo nuk kanë përgatitur një raport me shkrim për drejtorin, raport ky i cili do të paraprinte për nxjerrje të Vendimit nga ana e Drejtorit.
  - Vendimet e lëshuara nga ana e drejtorit të Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës, nuk janë protokolluara dhe të vëlosura.
  - Menaxhmenti ka lëshuar Vendime subjekteve afariste para lëshuarjes së Licencës dhe me këto Vendime subjektet kanë zhvilluar aktivitetin e tyre.
  - Menaxhmenti i kësaj Zyre kohe pas, ka urdhëruar zyrtarët që të dalin në teren për marrjen e mostrave të naftës dhe derivateve të naftës nga rezervuarët e subjekteve afariste me qëllim të verifikimit të cilësisë, me një veprim të tillë ka tejkaluar kompetencat e përcaktuara me ligji.
- Ne kemi konstatuar se një praktik e tillë është në kundërshtim me fushëveprimin e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës.
- Gjatë punës në teren janë ekzaminuar dhe testuar një mori dokumentesh.

## 1. PARATHËNIA

Procedurat e dhënies së Licencave rregullohen me Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2010 për Përcaktimin e produkteve të Naftës dhe Derivateve të saj, Procedurës së Licencimit dhe Llojet e Licencave për Subjektet që Ushtrijnë Veprimtari në Sektorin e Naftës, „Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2010 Për Përmbushjen e Kushteve Teknike nga Subjekti që Merren me Importin, Deponimin, Shitjen me Shumicë dhe Pakicë të Karburanteve“, „Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2010 Për Përcaktimin e Lartësisë së Taksave Për

Licencimin e Subjekteve nga Sektori i Naftës dhe Derivateve të Naftës, „Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2010 Për Ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/21 Për Licencimin e Derivateve të Lëngëta të Naftës” dhe „Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2010 Për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Licencimit të Sektorit të Naftës. Synimi i këtyre Udhëzimeve është që të sigurohet funksionimi i Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës në mënyrë efektive.

Ky auditim është bërë me Kërkesë të Sekretares së Përgjithshme si dhe në bazë të Ligjit të Auditimit të Brendshëm Nr. 03/L-128 Neni 1 dhe 2.

Ne kemi marrë në konsiderim se ka rreze domethënëse që të mos respektohen kërkesat ligjore sa i përket Procedurave të Dhënies së Licencave subjekteve afariste dhe se nuk ka kapacitet për përmbushjen e objektivave. Kjo na ka dërguar në atë që të zhvillojmë objektivat tona për auditim dhe të përcaktojmë një grup të testeve për të verifikuar nëse ekzistojnë kontrolle procedurale të nevojshme të menaxhmentit.

Përkufizimi të termave në Mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-138 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/5 Për Tregtinë me naftë dhe Derivate të naftës në Kosovë janë me sa vijon:

„Rezervat emergjente të derivateve të naftës Komision” - nënkupton sasi e derivateve të dedikuara për përdorim në raste të fatkeqësive të mëdha natyrore dhe të gjendjes së jashtëzakonshme

„Licencë” - nënkupton dokumentin me shkrim, të lëshuar nga ministri, të paraparë me këtë ligj, që personit të caktuar ia njeh të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar në sektorin e naftës dhe të derivateve të saj në Kosovë.

„ Të dhënat bazë” nënkupton shënime të regjistruara nga Zyra e Licencimit lidhur me emrin, adresën, numrin e naftës dhe të derivateve të saj në Kosovë. Ne kemi shfrytëzuar këto përkufizime për qëllime të auditimit.

## 2. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

### 2.1 Objektivat

- Verifikimi i plotësimit të procedurave për Licencimin e subjekteve afariste
- Verifikimi i plotësimit të procedurave për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e licencës.
- Verifikimi i plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e licencës.
- Verifikimi i plotësimit të kushteve teknike për import të karburanteve.
- Verifikimi i plotësimit të kushteve teknike për shitje me pakicë të karburanteve dhe

- Verifikimi i plotësisimit të kushteve teknike për shitje me shumicë të karburanteve.

## 2.2 Fushëveprimi

Zyra për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës - Mënyra e dhënies së licencave.

Periudha 2010 dhe 2011

## 3. Konstatimet

### 3.1. Konstatimet (Gjeturat) kryesore

Zyra për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës për punët që kryen ka raportuar në baza vjetor:

Veprimtaria themelore e Zyrës për Licencim është ti jap, ti vazdoje, ti pezulloj, ti ndryshojë ose ti revokojë licencat për veprimtari në sektorin e tregtimit dhe përpunimit të naftës dhe derivateve të naftës në pajtim me ligjin Nr. 03/L-138.

Çdo subjekt, për të ushtruar veprimtarinë e tregtisë me naftë dhe derivate të saj respektivisht subjektet të cilët merren me importin, deponim, shitjen me shumicë dhe pakicë të naftës dhe derivateve të saj në Kosovë janë të obliguara të licencohen.

#### Konstatimi nr. 1.

Në mbështetje të U.A. Nr. 07/2010 Për përcaktimin e produkteve të Naftës dhe Derivateve të saj, Procedurës së Licencimit dhe Llojet e Licencave për subjektet që ushtrjnë veprimtari në sektorin e naftës Neni 1.3, ku thuhet se; Dokumentacioni i bashkangjitur kërkesës, duhet të jetë në origjinal ose fotokopje të vërtetuara në gjykatë ose në organin kompetent.

- Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit kemi konstatuar se në shumicën e rasteve dokumentacioni është pranuar si kopje e pa verifikuar qoftë nga gjykatat ose nga organet përkatëse.

Ja disa raste:

- Subjekti afarist „ Bis Oil Team“ Sh.P.K me seli në Prishtinë, Zona Industriale
- Subjekti afarist „ La- Oil“ Sh.P.K. me seli në Prishtinë ( vërejtje: njëra për përmirësim të kodit tarifor dhe njëra e rregullt ),
- Subjekti afarist N.T.SH. „ Pagarusha euro Petroll- Gas“ me seli në Prizren,
- Subjekti afarist N.T. „ Standard Benz“ Sh.P.K- licenca për import të LPG-së me seli në Lipjan,
- Subjekti afarist N.T.P „ Flamuri“ me seli në Suharekë,

- Subjekti afarist N.T.P „ Nera Petroll“ me seli në Sojev – Ferizaj,
- Subjekti afarist N.T.Sh. „ Esnaf Petroll“ me seli ne Mamushë si dhe tjera.

#### Rekomandimi Nr. 1

Rekomandojmë menaxhmentin e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës që licencat të lëshohen konform „U.A. Nr. 07/2010 Për Përcaktimin e Produkteve të Naftës dhe Derivateve të saj“, Neni 1.3, ku thuhet se; „ Dokumentacioni i bashkangjitur kërkesës, duhet të jetë në original ose fotokopje të vërtetuara në gjykatë ose në organin kompetent“.

#### Konstatimi Nr. 2.

Për shqyrtimin e Kërkesave të parashtruara për licencim për tregtimin me naftë dhe derivate të saj Drejtori i Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës nuk ka lëshuar Vendim për formimin e Komisionit. Ne gjatë intervistave që kemi pasur me zyrtarët e kësaj Zyre, jemi informuar gojarisht se para lëshimit të Vendimit nga ana e Drejtorit kërkesat janë shqyrtuar prej tre (3) zyrtareve, por këta zyrtar asnjëherë nuk kanë mbajtur Procesverbal apo nuk kanë përgatitur një raport me shkrim për drejtorin, raport ky i cili do të paraprinte për nxjerrje të Vendimit nga ana e Drejtorit.

#### Rekomandimi Nr. 2

Rekomandojmë Drejtorin e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës që me rastin e shqyrtimit të kërkesave të parashtruara nga subjektet afariste për Licencimin për produktet e naftës dhe derivateve të saj, të nxjerr Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues dhe ky Komision me rastin e shqyrtimit të kërkesave të mbaj Procesverbal, si dhe të përgatit Raport me shkrim për Drejtorin, qoftë për dhënie, ripërtirje apo refuzim të Licencave konformë U. A. Nr. 01/2010 „Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Licencimit në Sektorin e Naftës“ Neni 5.1.

#### Konstatimi Nr. 3

Ne për shqyrtim të lëndëve kemi marr disa mostra dhe kemi konstatuar se, Vendimet e lëshuara nga ana e Drejtorit të Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës, nuk janë protokolluar.

Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit si dhe gjatë intervistave që kemi pasur me Zyrtarët e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës, dhe gjatë diskutimeve që kishim ne, ju kemi sugjeruar se çdo Vendim i marr duhet edhe protokolluar në momentin e marrjes së vendimit.

Ndërkohë gjatë kësaj periudhe zyrtarët kanë protokolluar disa Vendime dhe atë pas një periudhe prej 3 -4 muaj me vonesë prej momentit të marrjes së Vendimit.

Ja disa shterabuj;



- Vendimi Nr. 131, datë 08.03.2011 është protokolluar me datë 17.11.2011, protokoll Nr. 8209. ( me vonesë prej 8 muajve)
- Vendimi Nr. 339, datë 05.08.2011 është protokolluar me datë 17.11.2011, protokoll Nr. 8169 ( me vonesë prej 3 muajve).
- Vendimi Nr. 339, datë 05.08.2011 është protokolluar me datë 17.11.2011, protokoll Nr. 8169 ( me vonesë prej 3 muajve).
- Vendimi Nr. 394, datë 15.09.2011 është protokolluar me datë 16.11.2011, protokoll Nr. 8166 ( me vonesë prej 2 muajve).
- Vendimi Nr. 165, datë 29.03.2011 është protokolluar me datë 13.11.2011, protokoll Nr. 8144 ( me vonesë prej 8 muajve).
- Vendimi Nr. 347, datë 08.08.2011 është protokolluar me datë 09.11.2011, protokoll Nr. 8169 ( me vonesë prej 3 muajve), si dhe
- Vendimi Nr. 334, datë 14.07.2011 është protokolluar me datë 08.11.2011, protokoll Nr. 8023 ( me vonesë prej 4 muajve).

Ne po ashtu kemi identifikuar Vendimin Nr. 334 , datë 14.07.2011 i cili i është dhënë palës dhe një kopje figuron edhe në Shërbimin Doganor ku ka kryer shërbim pala dhe ka qen i pa protokolluar , dhe po ashtu i po njëjti Vendim i të njëjtës datë është protokolluar me 08.11.2011 me Nr. Protokoll Nr. 80.23.  
Një praktik e tillë lenë hapësirë dyshimi për manipulim

#### Rekomandimi Nr. 3

Rekomandojmë menaxhmentin e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës, që të gjitha Vendimet e lëshuara të protokollohen dhe të vulosen në momentin e marrjes së Vendimit, me qëllim të transparencës.

#### Konstatimi Nr. 4.

Kemi konstatuar se menaxhmenti ka lëshuar Vendime Subjekteve afariste para lëshuarjes së Licencës dhe me këto vendime subjektet kanë zhvilluar aktivitetin e tyre.

#### Rekomandimi Nr. 4

Rekomandojmë menaxhmentin që palës ti lëshohet Licenca konform Ligjit Nr. 03/L-138 për ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit Nr. 2004/5 Për Tregtinë me Naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, Neni 3.3 ku thotë se; Licencat i lëshon Ministri”

#### Konstatimi Nr. 5.

Veprimtaria themelore e Zyrës për Licencim është t'i jap, t'i vazhdoje, t'i pezulloj, t'i ndryshoj ose t'i revokoj licencat për veprimtari në sektorin e tregtimit dhe përpunimit të naftës dhe derivateve të naftës në pajtim me ligjin Nr. 03/L-138 , Neni 3.2.  
Gjatë intervistimeve me zyrtaret e Zyrës në fjale si dhe disa dokumenteve të

ofruara, kemi konstatua se menaxhmenti i Zyrës ka tejkalluar kompetencat e përcaktuara nga ligji i cituar më lartë.

Menaxhmenti i kësaj Zyre kohe pas kohe, ka urdhëruar zyrtarët që të dalin në teren për marrjen e mostrave të naftës dhe derivateve të naftës nga rezervuarët e subjekteve afariste me qëllim të verifikimit të cilësisë.

Ne kemi konstatuar se një praktik e tillë është në kundërshtim me fushëveprimin e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës.

#### Rekomandimi Nr. 5.

Rekomandojmë Menaxhmentin e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës, që aktivitetin e vet të zhvilloj konform Ligjit Nr. 03/L-133, Neni 3.2.

#### Konstatimi Nr. 6

Parashtruesi i kërkesës për licencim, për tu pajisur me licencë duhet ti paraqes Zyrës dëshmi për rezervuarët dhe vëllimin e tyre.

U.A. Nr. 07/2010, Për përcaktimin e Produkteve të Naftës dhe Derivateve të saj, Procedurës së Licencimit dhe Llojet e Licencave për subjektet që Ushtrinë Veprimtari në Sektorin e Naftës', Neni 4. alineja 1.11 përcakton se; parashtruesi i kërkesës duhet të ofroj dëshmitë për rezervuarët dhe vëllimin e tyre

- Ne kemi konstatuar se dëshmitë e ofruara nga subjektet afariste për rezervuarët dhe vëllimin e tyre nuk i kanë plotësuar kushtet e nevojshme

- nuk posedojnë datën e verifikimit,
- datën e skadimit,
- nuk janë të vulosura nga verifikuesi dhe nuk përmbajnë emrin e verifikuesit.

Dëshmia e përcaktuar për rezervuarët dhe vëllimin e tyre përcakton saktësinë e sigurimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta në 1€/litra të kapacitetit të rezervuarëve të naftës dhe derivateve të naftës për shitjen me pakicë apo deponim.

#### Rekomandimi Nr. 6

Rekomandojmë menaxhmentin e lartë që me rastin e pranimit të kërkesave për licencim të subjekteve afariste që tregtojnë me naftë dhe derivate të naftës ti obligojnë që, dëshmitë e ofruara për rezervuarët dhe vëllimin e tyre; të përcaktohet data e verifikimit, data e skadimit, kompania e cila ka bërë verifikimin si dhe të jenë të vulosura nga kompania kompetente.

### 3.2. Konkluzionet

Për arsye të çështjeve paraprake të përmendura në konstatimet më lartë, ne do të japim opinionin me rezervë lidhur me zbatimin e procedurave të Menaxhimit - Dhënies së licencave subjekteve afariste që merren me tregtimin me naftë dhe derivate të naftës për periudhën 2010 dhe 2011.

Pikat e përmendura më lartë në seksionin 3.1 kërkojnë një vëmendje të menjëhershme nga menaxhmenti i lartë.

Këto konkluzione na bëjnë të besojmë se Zyra për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës, nuk është duke vepruar në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe nuk është duke operuar në mënyrë efektive.

Pjesa në vijim paraqet rekomandimet tona për përmirësime, për adresimin e kësaj situate.

### 3.3 Rekomandimet

Në bazë të konstatimeve të cekura në seksionin 3.1, më lartë, ne rekomandojmë si vijon:

#### Rekomandimi Nr. 1

Rekomandojmë zyrtaret e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës që licencat të lëshohen konform „ U.A. Nr. 07/2010 Për përcaktimin e Produkteve të Naftës dhe Derivateve të saj“, Neni 1.3, ku thuhet se; „ Dokumentacioni i bashkangjitur kërkesës, duhet të jetë në original ose fotokopje të vërtetuara në gjykatë ose në organin kompetent.

#### Rekomandimi Nr. 2

Rekomandojmë drejtorin e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës që me rastin e shqyrtimit të kërkesave të parashtruara nga subjektet afariste për Licencimin për produktet e naftës dhe derivateve të saj, të nxjerr Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues dhe ky Komision me rastin e shqyrtimit të kërkesave të mbaj Procesverbal, si dhe të përgatit Raport me shkrim për drejtorin, qoftë për dhënie, ripërtrirje apo refuzim të Licencave konformë U. A. Nr. 01/2010 „Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Licencimit në Sektorin e Naftës“ Neni 5.1.

#### Rekomandimi Nr. 3

Rekomandojmë menaxhmentin e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës, që të gjitha Vendimet e lëshuara të protokollohen dhe të vulosen me qëllim të transparencës.

#### Rekomandimi Nr. 4

Rekomandojmë menaxhmentin që palës ti lëshohet Licenca konforme Ligjit

Nr. 03/L-138 për ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit Nr. 2004/5 Për Tregtinë me Naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, Neni 3. 3 thotë se; Licencat i lëshon ministri''

Rekomandimi Nr. 5.

Rekomandojmë Menaxhmentin e Zyrës për Licencim, Rregullim dhe Vëzhgim të Sektorit të Naftës, që aktivitetin e vet të zhvilloj konform Nr. 03/L-138 , Neni 3.2.

Rekomandimi Nr. 6

Rekomandojmë menaxhmentin e lartë që me rastin e pranimit të kërkesave për licencim të subjekteve afariste që tregtojnë me naftë dhe derivate të naftës ti obligojnë që, dëshmitë e ofruara për rezervuarët dhe vëllimin e tyre; të përcaktohet data e verifikimit, data e skadimit , kompania e cila ka bërë verifikimin si dhe të jenë të vulosura nga kompania kompetente.

#### 4. Plani i veprimit

Ju lutemi rishikoni të gjeturat e paraqitura më lart dhe përgjigjuni për të na treguar se a i pranoni ato apo jo. Nëse nuk i pranoni, ju lutemi na tregoni pse nuk i pranoni.

Po ashtu, ju lutemi rishikoni rekomandimet tona dhe aty ku i pranoni ato, ju lutemi të na jepni planet e juaja për zbatimin e tyre, duke përfshirë atë se çka do të bëhet, kur do të fillojë puna, kur do të përfundojë, çfarë rezultatesh pritni ju, dhe kush është personi përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese.

Përgjigja juaj do të inkorporohet në versionin përfundimtar të Raportit Final të auditimit.

Me respekt

Haki Maxhuni, Drejtor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm - MTI-së